REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK
OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

REFERENC-Ë:	Numër 02-07/26
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik
NGA/OD/FROM	Leonard Llolluni - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik
DATË/A	31.07.2026
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Procesverbal

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

PROCESVERBAL

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së shtatë (7), të Kuvendit së Komunës së Junikut, me datë: 31.07.2026, duke filluar në ora 10:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. Leonard Llolluni: i cili në fillim përshëndeti të gjithë të pranishmit në sallë, më pas e konstatoi se a janë prezent ne sallën e kuvendit 12 antarët e Kuvendit te Konunës së Junikut.

Anëtarët prezent;

1. Leonard Llolluni-Kryesues,AAK
2. Bedrush Hoxha-anëtar,LDK
3. Litafete Isufa-anëtare, LDK
4. Shpejtim Gacaferi- anëtar, LDK
5. Sadri Krasniqi- anëtar, LDK
6. Floris Miroci-anëtar, LDK
7. Blerta Syla-anëtare, LDK
8. Burim Kuçi-anëtar, AAK
9. Ajshe Gacaferi-anëtare, AAK (**Mungon**)
10. Aldi Gacaferi-anëtar, AAK
11. Arlinda Pepshi-anëtare, AAK
12. Alfred Gaxherri-anëtar, AAK
13. Jetmir Tofaj-anëtar, LVV
14. Elsa Hima-anëtare, LVV (**Mungon**)

15. Lulzim Gacaferi-anëtar, LVV (**Mungon**)

Rendi i ditës i paraparë

1. Informatë lidhur me gjendjen e Shërbimeve Publike në Komunën e Junikut, për periudhën Janar-Qershor 2026,
2. Shqyrtimi i raportit të Auditimit për pasqyrat finaciare vjetore të Komunës së Junikut për vitin 2025 dhe plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve,
3. Informatë lidhur me përfundimin e vitit shkollor 2025-2026, për institucionet Edukative-Arsimore në Komunën e Junikut,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i planit Zhvillimor të Arsimit në Komunën e Junikut, për periudhën 2026-2030 9Leximi i parë),
5. Shqyrtimi i Raportit financiar, Janar-Qershor 2026, në Komunën e Junikut,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i draft Planit për menaxhimin e Tokave Rurale 2026-2030 (leximi i parë),
7. Informatë mbi raportin e performances se Administratës të Komunës së Junikut, për peirudhën Janar-Qershor 2026,
8. Shqyrtimi dhe miratimi i draftit "Strategjia për Zhillim Ekonomik Lokal" 2026-2033, (leximi i parë),
9. Informatë reth korrje-shirjeve në Komunën e Junikut për vitin 2026,
10. Formimi i komisionit për emërimin e zonave të reja të qarkullimit në territorin e Komunës së Junikut,
11. Të ndryshme.

z.Jetmir Tofaj, përshendetje për të gjithë, lidhur me pikat e rendit të ditës nuk kam diçka për të thenë, por për kushtet këtu në sallen e kuvendit,e inkuaroj ekzekutivin që të krijojë kushte për mbajtjen e mbledhjes së kuvendit, e di se jeni duke berë investime, dhe është e kuptushme, por megjithëatë një ditë para mbajtjes së mbledhjes mundeni ta pastroni sallen, kjo është një kërkesë mjaftë bazike dhe që mund të realizohet.

z.Leonard Llolluni, kërkesë tjetër nuk ka, e qes ne votim rendin e ditës të paraparë për mbledhjen e sotit, kush është per? për 11 vota, kundër 0 vota, dhe abstenim 0 vota, konstatoi se rendi i dites u miratua.

1. Informatë lidhur me gjendjen e Shërbimeve Publike në Komunën e Junikut, për periudhën Janar-Qershor 2026,

Arsyetim dhe sqarim te kesaj informatës lidhur me gjendjen e sherbimeve publike nuk pati, pasi që mungonte drejtori por edhe zyrtari i lartë i drejtorisë së shërbimeve publike.

z.Shpejtim Gacaferi, përshnedetje për të gjithë, meqenëse drejtori nuk është këtu unë propozoj që kjo pikë të shtyhet për më vonë , ndoshta vjen ndonjë nga zyrtarët e drejtorisë së shërbimeve publike.

z.Burim Kuçi, përshendetje per te gjithe, me qene se nuk eshte drejtori dhe as zyrtari kerkoj qe kjo pike te shtyhet per mbledhjen e radhes se kuvendit.

z.Leonard Llolluni, ne po presim deri ne fund të mbledhjes per kete pike qe nuk vije askush nga drejtoria, e shtyjmë për mbledhjen e radhës.

2. Shqyrtimi i raportit të Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Junikut për vitin 2025 dhe plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve,

Sqarimin dhe arsyetimin e raportit te auditimit te pasqyrave finaciare vjetore e beri z.Arten Hamza, zyrtar i Lartë ne DBF, i cili fillimisht i pershendeti te gjithë, më pas e sqaroi para kuvendit , raportin e auditimit per pasqyra financiare dhe planin e veprimit.

z.Shpejtim Gacaferi, unë e pergezoj kryetarin e komunes se bashku me stafin e tij per punën e mirë dhe transparente, ketë nuk po e them unë, por po e thotë zyra e auditimit për pasqyrtar financiare vjetore për komunen e Junikut, unë jam që katër mandate në ketë kuvend dhe gjithmonë numri i të gjeturave dhe rekomandimeve është sjellë rreth numrit 24, asnjëher nuk kemi mundur të bijmë më poshtë, dhe ky numër dy të gjetura dhe katër rekomandime është po thuajse zero, dhe unë shpresoj që për një kohë të shkurtë këto dy të gjetura shumë shpejt te eliminohen krejt, ndërsa për ato katër rekomandime shpresoj që grupi punues besoj se do ti përfillë dhe të bejë zgjedhje që të eliminohen, dhe një herë përgëzime kryetar.

z.Jetmir Tofaj, fillimisht në e-mailin që kemi pranuar nga drejtoresha e DBF, raporti i auditimit na ka ardhë me disa faqe që mungojnë, ky është një dokument publik prandaj nuk e kuptoj arsyen se pse të na vije i mangët, kjo kuptohet nga numri rendor i faqeve ku nga faqja tre kalohet në faqen pestë, shtatë, nëntë e kështu me radhë dhe nuk e kam të qertë se pse ka ndodhur kjo? Sa i përket çeshtjeve, A1 te çeshtja e vonesave të pagesave të faturave dhe shpenzimeve tjera për pagesa të ekzekutuara nga thesari, nuk e di a është me u përgëzuar ku në emër të kamatës janë paguar 29499€, vlera e invesitimit kapital ka qenë 119334€, kamata ju ka marë pothuajse 30000€, apo ¼ e investimeve, nuk e di a duhet të përgëzohet, për shkak se për një komunë të vogël si komuna e Junikut 30000€ jane shumë e konsiderueshme, te çeshtja A2, unë e konsideroj që kjo është e turpshme të vije si e gjetur për shkak se numri i objekteve në Junik është 1134 dhe me arritur me i kryer vetëm 80 objekte apo rreth 7% është dobësi, në ketë rast është dobësi e zyrtarëve kryesor administrativ si përgjegjës për mbarëvajtjen e instuticionit të komunës, për çeshtje tjera nuk kisha hyrë në detaje por këto gjetje janë me të vërtetë shqetësuse sidomos kjo që në emër të kamatës është dashur te paguhet 30000€, por uroj që mos te përseritet, ndërsa sa i përket opinionit të pamodifikuar, ka shumë vite që komuna e Junikut që ka pranuar një opinion të tillë për pasqyrat financiare.

z.Arten Hamza, sa i përket gabimit teknik, unë po besoj se kur është dhenë materiali ka qenë në dy faqe dhe kur është skenuar është skenuar vetëm njëra faqe, sepse po që nisem nga numri i faqeve 3 mbas është faqeja numër 4, dhe nuk e di se si ka ndodhur kjo , përndryshe nuk ka ndonjë

tendencë për me fshehur sepse ndryshe ket raport mund ta gjeni edhe në faqen e zyrës kombëtare të auditimit është publik.

Në këto qaste në sallen e kuvendit hynë z.Bedrush Hoxha, tani në sallë prezent janë 12 anëtarë të kuvendit.

z.Shpejtim Gacaferi, vetem një sqarim , unë i qëndroj përgëzimit, por prita që çështja e kamatave qe u cek nga z.Jetmir Tofaj, prita që kjo të sqarohet nga ekzekutivi por meqenëse nuk u dha unë po e ceki se kamata janë si pasoj e kontratës kolektive.

z.Arten Hamza, duhet ta kuptojmë drejtë, sa i perket kësaj çeshtjes, kjo është një e gjetur të projektet kapitale, është një projekt i vitit 2020 për shtratin e lumit "Erenik" i cili në atë kohë eshtë dorëzuar fatura pas përfundimit të kontratës dhe nuk ka mundur të ekzekutohet pagesa, kontrata ka përfunduar në shtator ndërsa fatura na është prezentuar në dhjetor, dhe nuk kanë qenë kushte për tu paguar ajo faturë, ajo ka shkuar përmes procedurave gjygjësore pasi që operatori i ka pasur të përfunduara punimet dhe e ka fituar me proceduar gjygjsore dhe mjete i ka inkasuar mbsa kater viteve, fatura ka qene 119000€ por kur ti llogaritet kamata per ato karet vite per vones te pagese dhe kur ti shtohen kesaj edhe proceduar permbarimore, pra ajo shuma prej 29000€ eshte kamate dhe shpenzime permbarimore.

z.Jetmir Tofaj, si është e mundur që të mos paguhet për katër vite kjo faturë, a është sviduar nga ju përmes gjygjit, pse ka ndodhur kjo ketë nuk e kam të çartë?

z.Arten Hamza, në momentin që një faturë nuk pranohet në afatin e kontratës me raport të pranimit teknik dhe me konstatim që ajo është kryer mbrenda afatit të kontratës zyra e financave nuk mundet me e ekzekutuar faturën pa një vrndim që meret përgjegjësia se pse fatura ka ardhur mbas afatit të kontrates, fatura ka ardhe ne Komune e Junikut por nuk eshte pranuar sepse nuk kemi baze ligjore me e ekzekutuar dhe me pas operatori e ka kërkuar ketë të drejtë përmes gjykate dhe e ka fituar çeshtjen.

z.Jetmir Tofaj, në raport të auditimit po thuhet diçka tjetër, po thuhet se mospërgjeësia e zyrtarëve përgjegjës ka ndikuar ne mos realizimin e pagesave mbrenda afatit kohore ligjore, pra a ju eshte thene ky arsyetim i juaj dhe pse nuk është përfshirë në raport të auditimit.

z.Arten Hamza, ajo çka është shkruar është ajo çka ata mendojnë, dhe unë vetëm e shpjegova se si ka ndodhur me ate faturë, ne ju kemi prezentuar ashtu si ka qenë çeshtja, e kan mar edhe si kopje ketë lendë dhe e kan parë, dhe une nuk kam diçka tjetër për me shtuar më shumë për ketë çështje.

3. Informatë lidhur me përfundimin e vitit shkollor 2025-2026, për institucionet Edukative-Arsimore në Komunën e Junikut,

Sqarimin dhe arsytimin e informates lidhur me përfundimin e vitit shkollor 2025-2026, e bëri z.Xhavit Velijaj, drejtor i Drejtorisë se Arsimit, i cili fillimisht i përshendeti të gjithë më pas e sqaroi para kuvendit informaten lidhur me përfundimin e vitit shkollor 2025-2026 në instituconet edukativo-arsimore në komunën e Junikut.

Gjatë prezentimit të kësaj pike sallen e leshon anëtari i kuvendit z.Alfred Gaxherri dhe tash prezent janë 11 anëtar.

z.Jetmir Tofaj, kisha kërkuar qe edhe këtu kur të bëhet kërkesa për shqyrtim te raporti, kërkesa ti bashkangjitet edhe raport jo te na vije vetëm kërkesa, të bëhet si praktikë që ti bashkangjitet edhe raporti dhe ta kemi edhe më të qartë si raport.

z.Xhavit Velijaj, për shkak se në ketë raport nuk ishin të përfshira edhe disa informata që lidhen me mbarimin e mësimit dhe të konkurseve nuk kam mundur te ju dërgoj raportin e plotë mirëpo me qenë se tash janë këto informata në raprt dhe e kam të plotë raportin mundem me ju dërguar që tani nëse keni qasje në e-mail.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i planit Zhvillimor të Arsimit në Komunën e Junikut, për peridhën 2026-2030 9Leximi i parë),

Sqarimin dhe arsyetimi e pnlanit zhvillimor të arsimit në komunën e Junikut e bëri z.Xhavit Velijaj -drejtor në drejtorinë e arsimit.

z.Jetmir Tofaj, me të vërtet kam qenë i lumtur kur na ka ardhë kjo pikë, sepse vetë jam produkt i shkollës "Edmond Hoxha" dhe tani kam ne plan zhvillimor të arsimit në komunen e Junikut, ka qenë një gjë që më ka berë të ndihem mirë, por kjo nuk duket se zgjati shumë pasi që kur mora ketë plan me e lexuar dhe me shiquar përmbajtjen e ketij planit jam zhgënyerë shumë sepse në ketë plan ka shumë gabime drejtshkrimore, jam konsultuar edhe me një lektor dhe plani përmban 270 gabime drejtshkrimore prej të cilave 129 janë fjalë të shkruara gabim 83 janë mungesë ose perdorim i gabuar i shkronjës ë dhe q, 57 janë bashkim ndarje e hapsirës së gabuar dhe 21 janë kapitalizim i gabuar, po ashtu plani përmban edhe kalkulime të bëra gabim, shembull konkret në faqen 7 te tabela një, te rreshti dy, e kemi edukimi parashkollor ku thuhet se numri i nxënësëve meshkuj është tetë numri i nxenësëve femra është dhjetë. Gjithsejt bejnë 34, nuk bejnë 34, po ashtu tek tabela e tretë tek numri mësimdhenësve sipas niveleve për vitn 2025-2026 meshkuj nuk janë 14 ndërsa femra 44 gjithsejt 76 nuk janë 76 por 66, po ashtu në faqen 7 pragrafi i parë thuhet se është aprovuar nga kuvendi plani strategjik, ky plan nuk është aprovuar nga kuvendi,unë i kuptoj gabimet drejtshkrimore dhe ato kalkulime, por është një plan ku marin pjesë elita e arsimit te Komunes së Junikut, andaj konsideroj se pa u futur në përmbajtjen e ti pasi kemi kohë dhe jemi në fazën e dytë unë sot nuk mund të jap votë për, unë do të abstenoj me qëllim q të ju jap kohë edhe juve të beni këto përmirësime e nevojshme, pasi qe nuk dua që vota ime të jetë për, per një dokument të arsimit.

z.Xhavit Velijaj, e pranoj se ka gabime drejshkrimore, lektorimin e dokumentit nuk e kemi berë pë rshkak të kohës, ne jemi munduar qe ta mbrrimë ketë kohë sot ku jemi, sepse të gjithë ne qe jemi në ketë grup punues kemi edhe angazhime tjera dhe na është dashur angazhim shtesë që të mbrrijmë afatet për ketë plan zhvillimor, mirepo meqenëse ky dokument nuk është dokument final, sepse tash kemi edhe ndëgjim publik dhe më pas vjen edhe leximi i dytë për miratim në kuvend ne si grup kemi menduar që dokumentin final ta lekturojmë dhe ta sjellim në kuvend për miratim.

z.Burim Kuçi, kur e kam pranuar materialin përmes emailit, dhe bashkë me një ekspert gjuhësor e lexuam bashkë, dhe aty vërejtem gabime drejtshkrimore, dhe për qudi në përpilimin e këtij dokumenti ishin tre personat më kryesor të arsimit në komunën e Junikut, dhe për ketë arsye ne do të abstenojmë.

z.Leonard Llolluni, meqenëse është leximi i parë, mendoj se drejtori do ti mer parasysh këto vërejtje dhe në leximin e dytë do të na sjellë dokumentin pa këto gabime, nëse nuk ka kërkesë tjeter unë e qes në votim ketë pikë, kush është për që kjo pikë të miratohet me këto vërejtje qe u dhanë? Për, 6 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 5 , konstatoti se kjo pikë kalon.

5. Shqyrtimi i Raportit financiar, Janar-Qershor2026, në Komunën e Junikut,

Shqyrtimin dhe arsyetimin e raportit finaciar janar-qershor 2026 e beri znj.Ardita Hoxha-drejtoreshë ne DBF, e cila fillimisht i përshendeti të gjithë më pas e ssqaroi para kuvendit ketë raportin financiar janar-qershor 2026 ne Komunën e Junikut.

z.Burim Kuçi, desha disa sqarime shtesë, mirëmbajtja e rrugëve lokale në vlerë 7400€, deshta me ditë se për çka behet fjalë, dhe e dyta , çka nënkuptom kompenzimi i përfaqsimit mbrenda vendit, në vlere prej 2656€, dhe e fundit, nafta për ngrohje, për cilën ngrohje bëhet fjalë.

z.Arten Hamza, sa i përket pozicionit mirëmbajtja, në kontraten për mbeturina që kemi është e paraparë mirëmbajtja e 20000 m^2 e rrugëve, që i bie për çdo muaj të paguhen nga 780€ për pastrimin e rrugëve, ndërsa sa i përket kompenzimit, bëhet fjalë per dreka zyrtare, ndërsa për derivatet për ngrohje fjala është për, objektin e komunës dhe objektin e QKMF_se pasi që vitin e kaluar por edhe deri tani, deri sa te ndërrohet sistemi i ngrohjes, jane me ngrohje me naftë.

z.Jetmir Tofaj, nuk besoj se raporti ka lenë hapësirë me komentuar, sepse përmbyllet me fjalët, duke pasur parasyshë indikatorët e lartë, komuna e Junikut në periudhën janar-qershor 2026 ka arritur rrezultate të mira, pra e kanë vlersuar veteë në fund. Kështu që nuk na mbetetn neve shumë me folë, por kjo ishte interesante që drekat zyrtare i paskan kamofluar me ketë titull "perfaqsimi mbrenda vendit" dhe shuma prej 2656€ është kogja një shumë e lartë për një komune të vogël si komuna e Junikut, por hala me e lartë eshte shuma e perfomances në zyrën e kryetarit 6982€, a mundem me ditë se për qfar behet fjale? Poashtu edhe për shtesat tranzistore që mundeni me na sqaruar se për çka bëhet fjalë?!

z.Arten Hamza, sa i përket drekave zyrtare , ky emërtim nuk është ndërruar nga komuna, nga viti i kaluar qe ka hyrë ne fuqi plani i ri qe e ka aprovuar thesari, është ndryshuar emërtimi i kodit, nga dreka zyrtare në perfaqësim të mbrendshem, ndërsa te kategoria e pagave shtesa e perfomances, qeveria ketë vit e ka aprovuar pagen e 13, për të gjithë punëtorët e sektorit publik. Aty ku është paga e perfomancës bëhet fjalë për pagen e 13, ndërsa sa i perket shtesave tranzistore, për momentin shtesë tranzistore në komunën e junikut mere vetem auditori i mbrendshëm, pasi që me hyrejn ne fuqi të ligjit te pagave disa koficente qe kanë më të lartë ju është ulur paga, mirëpor aty është vendosur se ata që kanë pagën e lartë dhe ju është ulur koficenti por paga nuk ju ulet, marin një shtesë tranzistore për ta mbajtur pagen ekuivalente para se te hynë ne fuqi ligji i pagave.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i draft Planit për menaxhimin e Tokave Rurale 2026-2030 (leximi i parë),

Sqarimin dhe arsyetimin e draft planit për menaxhimin e tokave rurale e bëri z.Besart Tofaj-nënkryetar i Komunës Juniku, i cili fillimisht i përshendeti të gjithë më pas e sqaroi dhe e arsyetoi ketë plan për menaxhimin e tokave rurale 2026-2030 para kuvendit.

z.Jetmir Tofaj, pa u futur në përmbajtjen e këtij dokumenti në dy pikat që u prezentuan këtu ne kuvend që u prezentuan nga drejtorët përkatës, plani i zhvillimit te arsimit u prezentua nga drejtori i arsimit, ndërsa raporti finaciar u prezentua nga drejtoresha e Financave, sepse janë titullar të këtyre dikastereve dhe kështu duhet të funksionoj, ndërsa në një situatë normale ky plan duhet të na prezentohej nga drejtori për ekonimi dhe zhvillim apo edhe ndonjëri prej zyrtarëve të asaj drejtorie.

z.Besart Tofaj, sa i përket prezentimit, ato janë të emërtuar në bazë të udhëzimeve dhe kryetarit i delegohet e drejta për me e udhëzuar kryesuesin që në ketë rast kryesues i atij grupi jam unë.

z.Jetmir Tofaj, në domenin e ciles drejtori hynë ky plan?

z.Besart Tofaj, domenin e drejtorisë për ekonomi dhe zhvillim.

z.Jetmir Tofaj, kush është drejtor ne ketë drejtori?

z.Ruzhdi Shehu, kryetar i Komunës se Junikut, nuk ka të bejë me ketë, ky dokument i perfshinë shumë dikastere, dhe unë me vendim e kam emërtuar grupin punues dhe kryesues është nënkrytari pasi qe të miratohet nga kuvendi ky dokument mund të bartet te dikasteri i drejtorisë për ekonomi dhe zhvillim.

z.Jetmir Tofaj, gjashtë muaj shkuan tani jemi në muajnin e shtatë, dhe ende nuk kemi drejtor për drejtorinë pr ekonimi dhe zhvillim , por si doqoftë po kthehem te ky dokument, faqe 85, këtu thuhet se plani është për vitin 2026-2030, ndërsa objektivat, aktivitetet janë për vitet, 2026,27,28.

z.Besart Tofaj, kjo është kështu pasi që duhet të rehabilitohet me kornizën afatnesme buxhetore e cila po ashtu është tre vjeqare.

z.Leonard Llolluni, kërkesë tjetër nuk ka, e qes në votim ketë pikë, kush është për? Për 6 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 5 vota, konstatoi se edhe kjo pikë u miratua.

7. Informatë mbi raportin e performancës se Administratës të Komunës së Junikut, për peirudhën Janar-Qershor 2026,

Sqarimin dhe aryetimin e këtij raportit të perfomancës së administratës në komunën e Junikut e beri znj.Leonora Shehu- drejtoreshë ne DA, e cila fillimisht i përshendeti të gjithë më pas e sqaroi dhe e arsyetoj ket pikë para kuvendit.

z.Leonard Llolluni, kërkesë nuk ka kalojmë në pikën e radhës së ditës.

8. Shqyrtimi dhe miratimi i draftit strategjia për Zhillim Ekonomik Lokal 2026-2033, (leximi i parë),

Saqrimin dhe arsyetimin e draft strategjisë per zhvillim ekonomik e beri z.Besart Tofaj- nënkryetar i Komunës se Junikut.

z.Jetmir Tofaj, nuk kemi çka me e komentuar ketë pikë ku nuk kemi drejtor të këtij dikasteri, situata është aq sa komike po ashtu tragjike andaj unë edhe për ketë pikë abstenoj.

z.Ruzhdi Shehu, kryetar i Komunës së Juniku, të gjithe zyrtarët e komunës janë të angazhuar në përpilimin e dokumenteve strategjike për komunën, ka të angazhuar edhe eksperta, ndërsa sa i përket drejtorit edhe atë do ta kemi shumë shpejt.

z.Shpejtim Gacaferi, të gjithë e dimë se pergjegjës për të gjitha është kryetari i komunës, si për suksese ashtu edhe për deshtime poashtu kryetari e ka te drejtë qe ta delegoj një drejtor ti mbuloj dy drejtori nuk e ndalon askush poashtu mundet per çdo gjë të pergjigjet por mundet ta delegoj dikë që të pergjigjet dhe pak ka rëndësi a është drejtori a nuk është , per ne si kuvend është me rëndësi të na përgjigjen për qeshtjet që ne i ngrisim dhe pytjet qe ne kemi.

z.Leonard Llolluni, kërkesë nuk ka e qes ne votim ketë pikë, kush është për? Për 6 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 5 vota, konstatoi se edhe kjo pikë u miratua.

9. Informatë reth korrje-shirjeve në Komunën e Junikut për vitin 2026,

Sqarimin dhe arsyetimin einformatës mbi korrje-shirjeve në komunen e Junikut e bëri z.Besart Tofaj- nënkryetar i komunës së Junikut.

z.Leonard Llolluni, kerkese nuk ka, kalojme ne piken er radhes se dites.

10. Formimi i komisionit për emërimin e zonave të reja të qarkullimit në territorin e Komunës së Junikut,

Sqarimin dhe arsyetimin e formimit te komisionit per emërtimin e zonave të reja e bëri z.Zenun Shala- drejtori ne DUKM, i cili fillimisht i përshendeti të gjithë më pas e sqaroi dhe e arsyetoi para kuvendit, formimin e komisionit për emërtimin e zonave të reja të qarkullimit në territorin e Komunës së Junikut.

z.Leonard Llolluni, në ketë pikë e kemi shqyrtuar edhe ne mbledhjen e KPF_se dhe aty kemi vendosur qe ne ketë komision të perfaqësohen me nga dy anëtar secili subjekt politik që perfaqësohet në kuvendin e Junikut dhe një anëtar nga ekzekutivi pra me 7 antëarë, dy LDK,dy AAK dhe dy LVV dhe një ekzekutivi.

z.Shpejtim Gacaferi, nëse në KPF është vendosur qe ky komision ti ketë 7 anëtar, ne e dimë se sa i përket KPF_se ne e dimë se shumëçka kanë shqyrtuar dhe kanë votuar por kur qeshtjet kanë ardhur ne kuvend kanë ndryshuar, por për ketë rast neve si grupi i LDK_se na keni gjetur të pa përgaditur sepse ne terë biseden e kemi berë që kuvendi të perfaqësohet me nga një anëtar nga secili subjekt politik, dhe nje nga ekzekutivi dhe një nga OJQ_te. Por nëse vazhdohet që ky komision ti ketë shtatë anëtar ne si LDK kërkojmë një pauzë te shkurtër.

Pause prej 5 minutave

Pas pauze

z.Leonard Llolluni, në ketë pauzë nga perfaqsuesit e subjekteve politike të perfaqsuar në kuvendin e Junikut u dakortuam qe ky komision ti kete 5 anëtarë, secili subjekt me nga një anëtar, një anëtar nga ekzekutivi dhe nje nga OJQ, dhe nga ky rast i pres porpozimet:

LDK-z.Bedrush Hoxha,

AAK-z.Burim Kuçi,

LVV-znj.Elsa Himaj

Ekzekutivi-z.Zenun Shala

OJQ-z.Nezir Shehu

Kjo përberje qitet në votim, për 11 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatohet se themelimi i komisionit u miratua.

11. Të ndryshme.

z.Leonard Llolluni, fillimisht unë dua të ngriti një shqetësim që kanë bujqit tanë me ujitjen e tokave, kompania që menaxhon ujitjen e tokave Drini i Bardhë ju ka caktuar një tarifë prej 75€ për hektarë, që për bujqit është shumë e lartë, dhe unë mendoj se kjo shumë është e lartë ku marim parasysh atë se kjo kompani nuk benë asnjë investim në këto kanale të ujitjes, unë bujqëve ju kam thenë qe te shkojnë edhe te drejtoria për zhvillim ekonomik te kryetari i komunës qe ta ngrisin si çeshtje.

z.Ruzhdi Shehu-Kryetar i Komunës së Junikut, është e vërtetë ky shqetsim i bujqëve, drini i bardhe si agjencion qeveritar asnjë investim nuk e kanë berë, unë kam lënë takim me drejtorin e kësaj kompanie dhe poashtu do të shkoj edhe ne ministrinë e linjes që me gjetë formë se si të shkohet tutje dhe me kriju situata letsuese për bujqit.

z.Burim Kuçi, unë kamë disa shqetësime,
shqetsimi i parë ka të bejë me rrugët lokale, ka disa rrugë qe gati janë te mbyllyra nga shkurret, a jeni duke shikuar te merni masa sepse gjendja e tyre është vërtetë shqetësuese, shqetsimi tjetër ka të bejë me subvencionimin e OJQ_ve, komunat tjera vetem se i kanë subvencionuar OJQ, ndërsa në komune e Junikut ende nuk ka filluar po më intereson të di se a do të filloni dhe kur do të filloni?

z.Shpejtim Gacaferi, kur e debatuam pikën e tetë, ajo çka e kamë thenë ësht\ë në procesverbal, z.Jetmir Tofaj, u mundua që ato fjalë të mija ti përshtat siç i pershtaten atij, por ajo nuk qëndron , dhe unë deshta vetëm diçka tjetër ndërsa ai më interpretoje diqka tjetër, nëse interpretojmë njerin tjetrin ta interprrteojmë ashtu siç e ka thenë jo ashtu siç te konvenon, po ashtu po dua te kthehem te një shqetësim i më hershëm që ka të bejë me vendimin e nxjerrur nga mbledhja e kaluar që ka të bejë me votimin e Kornizes Afatmesme buxhetore (KAB), procesverbali do të jetë edhe pse sot nuk e kemi, aty kemi votuar 5 vota për dhe 5 abstenime dhe 1 kundër, nëse keni nxerrur vendim kundër këtij votini keni nxerrur vendim kundër kësaj vote, një veprim i tillë e cenon parimin themelor të demokracisë përfaqsuese dhe e zbeh rolin e Kuvendit si organ me i lartë vendimarres, ju si kryesues e keni per obligim te zbatoni rregulloren te respektoni rezultatin e votimit, jo ta zavendsoni ate me vlersimin apo deshirën e juaj, ju duheni ta ruani aturitetin, itergritetin dhe sigurisht edhe besushmerinë e kuvendit, veprimi i juaj në mbledhjen e fundit është vepër penale ne si grup i LDK_se kemi votuar pro KAB, akuzën që e ceka ka te bejë me nje shkresë që Komuna e Junikut e ka postuar në web-faqe ku thot se Kuvendi Komunal i Junikut e miraton Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029, nëqoftëse ajo ka kaluar si vendim keni berë shkelje në qoftë se ajo nuk ka kaluar jemi keqinformuar nga ajo web-eaqe, une nuk e di a ke nxerrur vendim a nuk ke nxerrë vendim.

z.Leonard Llolluni, sa i përket shqetësimit tënd, ti je i mirë të bësh politikë dhe po kthehesh në politikë, unë e kam dërguar vendimin ashtu siç ka kaluar ligjërisht, si vendim që ka kaluar këtu në kuvend, paraprakisht jamë konsultuar edhe me zyrtarët që e monitorojnë kuvendin dhe më kanë sygjeruar qe vendimin ta dergoj atë që e ka kaluar kuvendi, dhe vendimi është nxjerrur mbi bazën e votimit që ka ndodhur në kuvend në raundin e parë, dhe kur të na kthehet ligjshmëria atëherë është në rregull.
z.Shpejtim Gacaferi, kemi votuar, 5 vota për, 5 vota abstenim, dhe 1 votë kundër, dhe ju e ceket se nuk ka kaluar. Eshtë edhe procesverbali dhe me pas unë kam thenë se kalon, se vota abstenim është pranim në heshtje, bile me ju thënë të drejtëjn qyqarët e bejnë atë, por edhe mos votimi nëse në donjë rast ka por që e benë kuorumin edhe ajo konisderohet për ose kundër ka të votojnë shumica.

z.Jetmir Tofaj, kryesues herave tjera kur të përdoret gjuha jo parlamentare tu kisha lutur qe te ja terheqësh vërejtjen, sepse e drejta për më abstenuar është e drejtë ligjore, unë në ketë seancë pata disa apstenime dhe i tregova edhe arsyet, deri tani kemi qenë shumë bashkëpunues si kuvend komunal, përkundër asaj qe jemi opozitë, nuk kemi qenë bllokues dhe gjërat kanë kaluar dhe ketë nuk e bejmë per juve si pushtet dhe as për neve si opozitë, por po e bejmë për qytetarët te komunës se Junikut andaj termat e tillë nga grupi parlamentar i pushtetit duhet të jenë më te kujdeshme në gjuhën që e përdorin ndaj njëri tjetrit.

z.Ruzhdi Shehu, kryetar i Komunës së Junikut, sa i përket shqetësimeve që u ngriten nga z.Burim Kuçi, komuna nuk ka ndarë buxhet për pastrimin e rrugëve nga shkurrat, dhe ne si komune jemi duke menduar që të bejmë praktikë si komunat tjera që aty ku ka shkurret të hiqen vetë nga pronartë e e atyre tokave, sepse shumica e këtyre shkurreve janë ne pronë private, ketë gjendje e kam edhe vete ne pronën time, ndërsa sa i përket subvencioneve, mjete që i kemi paraparë na i ka tërhequr përmbaruesi, por me themelimin e kuvendit të ri në qendër do të bejmë kërkesa që te na mbështesin dhe të ruhet ky standard që kemi berë.

z.Jetmir Tofaj, kryetar ju si institucion duheni te kujdeseni për mirëmabjtjen e rrugëve, prerjen e vegjetacionit, largimin e shkurreve ku ka, është obligim i juaj dhe rrugët të janë të pastra dhe të qasëshme për automjete, beni planifikimet me kohë dhe të ketë kontratë aktive për mirëmbajtjen e rrugëve, e kamë edhe një çështje, disa reklama që janë të vendosura mirësevini mërgimtar mbi qfarë kontrate janë t vendosur, a paguan komuna për ti vendosuar apo janë pjesë e marreveshje me operatorin, dhe ajo çka po me intereson është se kush i paguan?

z.Ruzhdi Shehu, kryetar i Komunës s Junikut, operatori e ka ne shfrytëzim dhe unë e kamë paguar privatisht .

z.Leonard Llolluni, e shpalli të mbyllur mbledhjen e korrikut 2026.

Procesmbajtësi:
z. Esat Hoxha

Kryesuesi i Kuvendit
z. Leonard Llolluni